



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**MINISTRIA E INTEGRIMIT  
EUROPIAN**

## Organizohet panairi për Programet e financuara nga BE

2017-05-11 10:17:00



Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshja, mori sot pjesë në Panairin për Programet e financuara nga Bashkimi European, i organizuar nga EU Info Center. Ky aktivitet vjen në kuadër të javës së Europës.

**Ministrja Gjoshja: Falë kësaj ndihme shumë familje shqiptare kanë krijuar modele suksesi**

Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshja, mori sot pjesë në Panairin për Programet e financuara nga Bashkimi European, i organizuar nga EU Info Center. Ky aktivitet vjen në kuadër të javës së Europës.

“Unë nuk do ndalem gjatë në shifra, por vlen të theksoj se asistenca e BE-së për Shqipërinë ka qenë e konsiderueshme me një total fondesh pre 595 milionë euro, për IPA I, e me një trend të dukshëm rritës për IPA II me një total prej 650 milionë euro”, tha Ministrja Gjoshja.

Ministrja shprehu vlerësime për punën dhe kontributin e çmuar të të gjithë aktorëve të përfshirë.

“Mbetemi të përkushtuar që të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjitha institucionet anembanë vendit, shoqërisë civile dhe organeve evropiane për të mirën e Shqipërisë dhe të axhendës së saj evropiane”, u shpreh Ministrja

Ministrja Gjoshja, theksoi se falë kësaj ndihme, shumë gra dhe vajza, të rinj e familje shqiptare janë bërë pjesë e projekteve duke parë jo vetëm një mundësi të re për një jetë më të mirë, por duke vënë në dispozicion aftësitë e tyre, vlerat, talentin për të ndërtuar pikërisht ato modele suksesi për të cilat Shqipëria ka sot më shumë nevojë.

“Në vlerë njerëzore, kjo është mbështetja më e madhe që na është dhënë sot nga partnerët tanë, ndaj në emër të këtyre familjeve unë dua t’iu shpreh mirënjohjen më të sinqertë”, tha Ministrja Gjoshja.